



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

V. KA.nr.1-7/2022

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë prej Luljeta Jashari Hertica – Kryetar Kolegji, Shpetim Sadiku dhe Drenushë Berisha - anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti, Administratore e Zyrës Disiplinore në OAK-në, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vendosur sipas ankesës nr. 1-5/2022, të datës 12/04/2022 e ushtruar nga fletëparaqitësja _____, kundër vendimit të Kolegjit Disiplinor nr.1-4/2022 i datës 09.03.2022, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 25.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa nr. 1-5/2022, të datës 12/04/2022 e ushtruar nga fletëparaqitësja _____, si e bazuar ashtu që **ANULOHET** Vendimi i Kolegjit Disiplinor nr.1-4/2022 të datës 09.03.2022.
- II. APROVOHET** Propozimi i Prokurorit Disiplinor të OAK-së me nr.42-3/2020, i dt. 20.01.2022.
- III. Shpallet përgjegjës** i paraqituri _____ për shkelje disiplinore konformë nenit 118 par 1.3 dhe par.1.13 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 5 të KEPA-së dhe shqiptohet masa disiplinore - dënim me gjobë në shumën prej 500 euro.
- IV. Obligohet i paraqituri** _____ që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 50 euro, në buxhetin e OAK-së, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Procedura në këtë çështje është iniciuar me dt.16.06.2020 përmes fletëparaqitjes nr.42/2020 të _____. Duke vepruar sipas kësaj fletëparaqitje, Kolegji Disiplinor i OAK-së përmes Vendimin nr.1-4/2022, datës 09.03.2022, është liruar nga përgjegjësia disiplinore i paraqiturin _____ me seli në _____ adresa _____, me arsyetimin se provat e prezantuara nga fletëparaqitësja dhe Prokurori disiplinor nuk kanë qenë bindëse për Kolegjin e Komisionit Disiplinor. Komisioni ka administruar provat si në vijim: Propozimi nr. 42-3/2020, i dt 20.01.2022; Fletëparaqitja 42/2020, e dt.16.06.2020; Njoftimi i ZPD-së të OAK-së, me nr. 42-1/2020, i dt. 04.08.2020; Përgjigjja me numër 42-2/2020 e dt. 15.09.2020; Aktvendimi C.nr.438/2018, i dt. 29.04.2020; Aktvendimi i trashëgimisë T.nr.12/70, i dt. 10.10.1975; Autorizimi noterial, i dt.10.09.2018; Autorizimi i dt. 18.05.2019; komunikimet me viber (një faqe); ankesa C.nr.338/2018, e dt.27.05.2020.

Kundër këtij vendimi, në afatin ligjor, me dt.12.04.2022 ka ushtruar ankesë fletëparaqitësja [redacted], me arsyetim se vendimi i atakuar “*është shkelje ndaj Kodit të Etikës Profesionale të Avokatisë, pasi që avokati ka bërë shkelje të rëndë disiplinore*”, me propozim që i njëjti të anulohet, dhe se e njëjta ka paraqitur autorizim të noterizuar nga bashkëshorti i saj [redacted] i cili e ka autorizuar që të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike në emër dhe për llogari të tij sepse i njëjti ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe jo krejtësisht i aftë që të mund të kuptoj veprimet e tij e kjo vërtetohet edhe nga fakti se avokati e ka vizituar në shtëpinë e tij para seancave gjyqësore sepse i njëjti nuk ka mundur të lëviz nga shtrati.

Komisioni i ankesave ka caktuar dhe mbajtur seancën Kryesore – Dëgjimore, ku pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, vendosi njëzëri se ankesa e ushtruar nga fletëparaqitësja [redacted], është: **e bazuar.**

Komisioni i Ankesave i shqyrtoj dëshmitë, procesverbalet dhe provat e cekura si më lartë, dhe konstatoi se: [redacted] në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil e ka përfaqësuar në procedurë kontestimore bashkëshortin e fletëparaqitëses [redacted] (në cilësinë e paditësit), me ç’rast avokati në fjalë ka pasur autorizim për përfaqësim në këtë çështjen juridike - civile për anulimin e kontratës së shitblerjes së një pasurie të paluajtshme, e cila ka qenë pronë e vëllait të paditësit dhe pas vdekjes së tij bashkëshortja i’ka kishte shitur të paditurit [redacted] me pretendim nga pala paditëse se ajo kontratë ka qenë e falsifikuar. Në lidhje me këtë çështje kontestimore avokati në fjalë ka prezantuar në 4 seanca gjyqësore dhe atë me dt.05.06.2020, dt.02.07.2020, dt.02.09.2020 dhe 04.10.2020, ndërsa për këtë lëndë është autorizuar në muajin Maj të vitit 2019. Megjithatë në seancën e dt 24.02.2020 nuk ka marrë pjesë, për të cilin shkak Gjykata Themelore në Gjakovë e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Sipas Komisionit Disiplinor të cekur në arsyetim të vendimit të atakuar, *është vërtetuar se nuk ka elemente të falsifikimit të nënshkrimit*, megjithatë Komisioni i Ankesave rreth kësaj çështje ose rreth këtij konstatimi në shkresat e lëndës nuk ka asnjë vendim të formës së prerë qoftë nga Prokuroria për pushim të hetimeve, hedhje vendim nga Gjykata.

Në pretendimet e avokatit se paditësi – bashkëshorti i fletëparaqitëses ka pasur pajtim që avokati mos të prezantoj në seancë, as për këtë rrethanë në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë qoftë në formë të marrëveshjes, revokimit të autorizimit, denoncim apo diçka që do të mund të bindte Komisionin e Ankesave se i njëjti ka vepruar konform dispozitave ligjore.

Për më tepër, edhe pse i njëjti nuk ka prezantuar në seancë dhe nuk e ka bërë denoncimin e autorizimit, prapë ka ndërmarrë veprime juridike duke ushtuar mjetin e rregullt juridik në Gjykatën e Apelit, por vetëm sa i përket shpenzimeve procedurale. Në këtë rrjedhë, avokati në fjalë nuk ka vërtetuar me asnjë provë faktin se pala ka kërkuar ta atakojnë vendimin për tërheqje të padisë vetëm sa i përket lartësisë së shpenzimeve procedurale.

Me dispozitën e nenit 94 të Ligjit të Procedurës Kontestimore RKS-së, është përcaktuar se:

1. Pala mund ta revokoj në gjdo kohe prokurën, kurse përfaqësuesi mund ta denoncoj atë në gjdo kohë.
2. Revokimi, respektivisht denoncimi i prokurës duhet ti komunikohet Gjykatës në të cilën zhvillohen procedurat, me shkrim ose gojarisht në procesverbal.

3. Revokimi respektivisht denoncimi i prokurës vlen për palën kundërshtare që nga momenti kur ti jete komunikuar.
4. Pas denoncimit të prokurës përfaqësuesi i prokurës ka për detyrë që edhe 15 dite të kryej veprime procedurale për palën që ja ka dhenë atë, po që se është nevoja që të evitohet ndonjë dem që mund ti shkaktohet brenda kësaj kohe. Në kuptim të kësaj dispozite edhe po që se avokati do ta denonconte prokurën apo pala do ta revokonte atë, përfaqësuesi i autorizuari (avokati) detyrohet që edhe 15 ditë të vazhdoj të ndërmarë veprime procedurale kur ekziston mundësia e shkaktimit të ndonjë dëmi eventual.

Veprimet e të paraqiturit Kolegji i Ankesave i ka vërtetuar nga mungesa e provave me të cilat do të vërtetohej se pala dhe avokati janë pajtuar që ky i fundit të mos të prezantojnë në seancë, njoftimi nga avokati për pasojat juridike të mos prezencës në seancë gjyqësore, dëshminë se është revokuar / denoncuar autorizimi apo se është tërhequr lënda, dëshmi me shkrim se janë marrë vesh që avokati të ushtroj ankesë në Gjykatën e Apelit vetëm për shpenzimet procedurale, vendimin e plotfuqishëm të gjykatës me të cilin është vërtetuar falsifikimi i nënshkrimit të paditësit lidhur me çështjen kontestuese në gjykatë.

Sipas Komisionit të Ankesave si komision i shkallës së dytë, Komisioni i shkallës së parë Komisioni Disiplinor nuk ka vendosur në mënyrë meritore, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje disiplinore dhe atë shkelje nga neni 118 paragrafi 1.3 dhe 1.13 lidhur me nenin 5 të KEPA-së, pasi që pala është laike, nuk ka njohuri për pasojat juridike nga lëshimi i kryerjes së veprimeve procedurale dhe se detyrimisht përgjegjësit e avokatit janë që gjithçka rreth lëndës të përpiloj me shkrim dhe me kohë ta njoftoj palën për të gjitha çështjet juridike lidhur me lëndën.

Me mospërpilimin e asnjë akti juridik avokati [redacted] ka kryer shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 paragrafi 1.3 dhe 1.13 të statutit të OAK-së, lidhur me nenin 5 të KEPA-s, sepse me veprimin e bërë ka keqpërdorur autorizimin dhe besimin e klientit si dhe ka ushtruar punën e avokatit në mënyrë të pandërgjegjshme sepse pala është laike ndërsa avokati duhet të marrë veprimet me profesionalizëm.

Komisioni Ankesave ka ekzaminuar edhe sa i përket llojit të masës disiplinore dhe lartësisë të shqiptuar ndaj të paraqiturit, dhe erdhi në përfundim se masa disiplinore e shqiptuar është në harmoni me dispozitën e nenit 123 paragraf 2 të Statutit të OAK-së. Komisioni i Ankesave konsideron se me një masë të tillë arrihet qëllimi i masës disiplinore ndaj të paraqiturit.

Komisioni i Ankesave sipas detyrës zyrtare është kujdesur lidhur me afatin e parashkrimit, dhe një zëri konstatoj se nuk është arritur parashkrimi në këtë çështje disiplinore.

Kolegji i ankesave në pajtim me nenin 51 paragraf 2, nënparagraf 2.1 të Ligjit për Avokatinë, nenin 123 paragraf 3 të Statutit të OAK-së të paraqiturit, Avokatit [redacted] i ka shqiptuar masën disiplinore Gjorbë në shumë prej 500 €, si dhe në emër të paushallit disiplinor shumë prej 50 €, me paralajmërimin se gjoba dhe paushalli duhet të paguhet në buxhetin e OAK-së, në afat prej 15 dite nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Komisioni për Ankesa në mbështetje të dispozitave nga neni 110 paragraf 1 të Statutit të OAK-së, dhe nenit 46 paragraf 1 pika 1.3, nenit 49 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
KA.nr. 1-7/2022 të datës 25.10.2022

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Kryetari i Kolegjit për Ankesa
Av. Luljeta Jashari Hertica

